



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.1580/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në rr. “Qamil Hoxha”, në Prishtinë, kundër debitorit “A.B.” B.I., me seli në rr. “Muhamet Çami” p.nr, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.Sh., avokat në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.215/23 të datës 18.07.2023, me datën 24.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit “A.B.” B.I., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.215/23 të datës 18.07.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.215/23 të datës 18.07.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit A.B.” B.I., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.708/22 i datës 04.01.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

**-Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit përbarues - Vendimit 01.Nr.60-14/2021 i datës 07.07.2021, me të cilin ka caktuar zbatimin e përbarimit, ndaj debitorit "A.B." B.I., me seli në Prishtinë të cilin e ka detyruar që kreditorit t'ia paguaj shumën e borxhit prej 2,500.00 €, në emër të masës ndëshkimore si dhe të shpenzimet e procedurës përbarimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe sendet e luajtshme në pronësi të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ndër të tjera ka deklaruar se nuk është bërë vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, ndërsa në lidhje me vendimin e shqiptuar debitorit nuk i është dhënë e ushtrimi të ankesës, për shkak se nuk e pranuar asnjëherë asnjë vendim nga kreditori. Më tutje ka theksuar se ky detyrim nuk është shkaktuar fare, ashtu që debitori i ka përmbushur në tërësi detyrimet ndaj stafit të punës dhe nuk ka përgjegjësi ligjore sa i përket shqiptimit të gjobës. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit në tërësi si i bazuar, të anulohet urdhri përbarimor si dhe të obligohet kreditori që t'ia paguaj të gjitha shpenzimet procedurale.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi thëniet në prapësim të debitorit, duke theksuar se urdhri për përbarim është në përputhje me

dispozitat ligjore dhe i njëjti është detyruar që këtë borxh ta kërkojë përmes procedurës së përmbarimit si rezultat i mos pagesës së detyrimeve të debitorit brenda afatit vullnetar për pagesë. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin për përmbarim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.215/23 të datës 18.07.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit A.B.” B.I., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.708/22 i datës 04.01.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj.

Në arsyetim të aktvendimit Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se Vendimi 01.Nr.60-14/2021 i datës 07.07.2021, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma 3 dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi 01.Nr.60-14/2021 i datës 07.07.2021, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27

paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarrimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarrimor të papërshtatshëm për përmbarrim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi 01.Nr.60-14/2021 i datës 07.07.2021 është dokument i përmbarrueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 06.01.2022, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarrim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbarrueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarrim. Arsye këto nga të cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si të tilla mbeten vetëm në natyrën deklarative, të pambështetura në prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II nr.1580/23, me datë 24.04.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti